

V E N D I M
Nr. 137, datë 31.3.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E ARTIKUJVE ENERGJITIKË

(Ndryshuar me VKM nr. 441, datë 21.8.1995; nr. 409, datë 1.7.1998; nr. 602, datë 2.11.2001)

(i përditësuar)

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të disa artikujve energjetikë, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.313, datë 28.6.1993 "Për rritjen e çmimeve e tarifave të disa artikujve të shportës", ndryshohen si vijon:

- a) Vajguri20 lekë /litri
- b) Ngrohja e përqëndruar e banesave:
 - Me avull 40 lekë për një m3 mjedis të ngrohur
 - Me gaz të lëngët (me bombola)..... 40 lekë/kg
 - Me gaz natyror (me tubacione), sipas periudhave:
- Prill-Tetor..... 950 lekë/muaj
- Nëntor- mars1600 lekë/muaj

c) Çmimet e shitjes së druve të zjarrit dhe të qymyrgurit liberalizohen.

Për gjithë artikujt që përfshihen në këtë pikë, shteti ndërpret subvencionimin për diferenca çmimi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja të shitjes me pakicë të tyre dhe atyre të mëparshme derdhen detyrimisht në buxhetin e shtetit, për sasi të që do të jenë gjendje pranë subjekteve shtetërore përkatëse, në datën e zbatimit të çmimeve të reja të mësipërme.

Organet përkatëse të pushtetit lokal të kontrollojnë dhe të marrin masa për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemimin e diferencave të çmimeve dhe derdhjen e tyre në buxhetin e shtetit.

2. *Shfuqizuar.*

3. Ngarkohen të gjitha ministritë përkatëse të nxjerrin udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.507, datë 26.10.1993 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.207, datë 4.5.1993 "Për çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike", si dhe të gjitha çmimet dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT E TJERË JO FAMILJARE¹

ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT E TJERË JOFAMILJARË

Emertimi Nr. i përdoruesve	Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kv)		Furnizimi nga rrjeti i TM (6., 10 dhe 20 kv)						Furnizimi nga rrjeti i TU	
			Matja në nënstacion		Matja në primar të transformatorit		Matja në sekondar të transformatorit			
	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lek për 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarifa fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh	Tarif fikse Lekë/kw	Çmimi Lekë për 1 kwh
1. Subjekte prodhuese	40	3.3	50	3.5	50	3.6	50	3.8	60	4.5
2. Subjekte të sferës së shërbimit, tregtimit, hoteler, ente, zyra, rek- lamë etj., sipas periudhave:										
1 Prill-Tetor	-	-	50	3.0	50	3.2	50	3.4	60	4.2
2. Nëntor-Mars	-	-	50	5.3	50	5.6	50	6.0	60	8.0

SHËNIM: 1. Llogaritja e tarifës fikse bëhet sipas fuqisë së instaluar të transformatorit ose të përdoruesve. Për përdoruesit që do të vendosin limitator (çelës automat), llogaritja e kësaj tarife bëhet në bazë të fuqisë maksimale të limitatorit të vendosur.

2. Në rastet kur përdoruesi kërkon të vendosë matës me dy tarifa (ditë-natë), çmimi i energjisë elektrike të jetë 1.2 herë më i lartë për ditën dhe 0.6 herë për natën, kundrejt çmimit bazë të caktuar për të.

¹VKM nr. 441, datë 21.8.1995 në pikën 2 shprehet;

"2. Në paragrafin e katërt, të gjitha çmimet e energjisë elektrike të caktuara në tabelën e çmimeve të energjisë elektrike për përdoruesit e tjerë jofamiljarë rriten përkatësisht si vijon:

- Çmimet e caktuara në pikën 1 të tabelës rriten në masën 0,3 lekë për çdo kilovatorë.
- Çmimet e caktuara në pikën 2 të tabelës rriten në masën 0,6 lekë për çdo kilovatorë."